



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 741/ 2 prot

Datë 07.04.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK**  
**ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI OFERTUESIT E TJERË**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-61945-03-09-2023 me objekt “*Blerje për veshje pune*” me fond limit 4,000,100 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria “ECO – ELB” sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** “Malbertex” SHPK  
*Rr. “Zenel Bastari”, Blloku i Magazinave, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqeria “ECO – ELB” sh.a  
*Lagja “Brigada 17 Sulmuese”, bulevardi “Qemal Stafa”*

**Subjekte të Interesuara:** “Gentian Sadiku” PF  
*Rruga Tom Plezha, Pallati Milo, Nr 7, zone kadastrale 3866 pasuri 298/211-N11, Yzberish, Kashar, Tirane*

Në datën 06.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 741 prot., e operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-61945-03-09-2023 me objekt “*Blerje për veshje pune*” me fond limit 4,000,100 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria “ECO – ELB” sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 741 prot, datë 06.04.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

*“OE nuk ka paraqitur autorizim të vlefshëm nga prodhuesi /distributor ( Safety Albania) , autorizim pa vule të njome, autorizimi nga BLN (Prodhuesi) nuk përmban të dhëna të plota mbi prodhuesin si adresa, email ,nr tel dhe nr fax. OE nuk plotëson Kriterin 2.3.4 të DST pasi nuk ka paraqitur Certifikaten e Akreditimit për laboratorin. Sipas flete analize të paraqitur nga OE për artikullin Kominoshe Pune , specifikimet teknike të kerkuara nuk përmbushen (peshat specifike dhe tendosja) Dokumenti I paraqitur si skedë teknike nga OE, nuk mund të pranohet nga AK pasi nuk përmban të dhënat baze që duhet të përmbajë një skedë teknike dhe është e nënshkruar nga OE I cili sipas QKB nuk rezulton të jetë prodhues për veshjet e punes.”*

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik “Malbertex” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF, si më poshtë:

*2.3.5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Testimi (fletë-analizë) për elementet të paraqitur në tabelën e mëposhtme për artikullin: “Kominoshe”, “Xhup fosforishent”, të lëshuar nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi, që vërtetojnë përpunueshmërinë e*

produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

<b>Kominoshe</b>		
<b>Karakteristikat</b>	<b>Standandarti i testimit</b>	<b>Kërkesat</b>
Përbërja	ISO 1833	65% Poliestër 35% Pambuk +-3%
Thurja	ISO 7211-1	Garniturë
Numri i fijeve	ISO 7211/2	Warp: 46niti/cm Weft: 19 niti /cm
Pesha	ISO 3801Part III	245 g/m <sup>2</sup> +-3%
Qëndrueshmëria në këputje /N	ISO 13934-1	Length >1350 N Width >480N +- 3%
Rezistenca ndaj konsumit	ISO 13937-1	Warp > = 20 N Weft > = 20 N
Dimensioni i Stabilitetit	ISO 5077	Warp < 2% Weft < 2%
Rezistenca ndaj konsumit(piling) – 1000 cikle	EN ISO 12945-1	4
Ngjyra		
Rezistenca e ngjyrës ndaj djersitjes (acid)	EN ISO 105-E04	4
Rezistenca e ngjyrës ndaj fërkimit të thatë dhe të njomë	EN ISO 105-X12	4
Rezistenca e ngjyrës në larje	EN ISO 105-C06	4

<b>Xhup Fosforishent</b>		
<b>Karakteristikat</b>	<b>Standarti i Testimit</b>	<b>Kërkesat</b>
Përbërja e materialit		100% Poliestër PU
Ngjyra		Fosforishente Jeshile
Masa	ISO 3801	200 g/m <sup>2</sup> (±5%)
Thurja	ISO 3572	Twill 2/2
Tkurja në larje 5x40 <sup>0</sup> C	ISO 6330 4N, F	Vertikal: ≤3% Horizontal: ≤3%
Elasticiteti	ISO 13934-1	Vertikal: 80 daN Horizontal 60 daN
Rezistenca në grisje	ISO 4674-1 meth B	Vertikal: >32 N Horizontal: >30 N
Qëndrueshmëria e depërtimit të ujit	ISO 20811	≥ 10m
Efeki pilling (kokrizimi)	ISO 20811	≥ 10m
Qëndrueshmëria e ngjyrës pas larjes në 40 <sup>0</sup> C	ISO 105 C06 CIS	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj fërkimit (me të njomë dhe me të thatë)	ISO 105 X 12	3 – 4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës	ISO 105 B02	4
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersitjes	ISO 105 E 04	4

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 07.04.2023

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**